



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN
PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 TË
BASHKISË SHKODËR”.**

Konsultim publik: *Banorët e Rajonit nr. 3*

Data: 18.10.2022

Ora: 13.00

Vendi: *Salla e Këshillit Bashkiak Shkodër.*

Numri i pjesëmarrësve: *Numri i pjesëmarrësve 20, nga të cilat 7 gra dhe vajza.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet: *Për draft projekt planin buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Shkodër*

Pjesëmarrës: Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi bashkë-drejtohet nga Zv/Kryetari i bashkisë dhe përfaqësues të Këshillit Bashkiak të cilët bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me:

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morën fjalën, diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon:

Hapja konsultimit nga Zv/Kryetari i Bashkisë, fjala përshëndetëse dhe prezantimi i pjesëmarrësve pjesë e stafit të Bashkisë Shkodër në takim.

1. Arsimi bazë parashkollor i Mesëm dhe i Përgjithshëm.

Anton Deda, Drejtor i Zyrës Arsimore Shkodër - kemi qënë në ndjekje të vazhdueshme të problematikave që ka rajoni 3 dhe në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të Arsimit kemi bërë ndërhyrje. Do të shohim edhe me përiudhën e rreshjeve dhe të ftohtit a kanë pasur rëndiment investimet e bëra në këto shkolla për të parë a janë në rregull hidroizolimet e bëra. Kemi marrë bazën materiale për ngrohjen e shkollave dhe jemi në kontakt për çdo nevojë në vijim.

Ervin Gjini – Problematikë për shkollat është sidomos zënia e pronave publike nga privati, kufiri i shkollës “Branko Kadija” dhe “Jordan Misja” ka problem ndërhyrjet nga privati në oborret e tyre. Duhet të verifikohen titujt e pronësise në këto oborre:

Zv. Kryetari – me sa kam dijeni është bërë edhe një mbledhje me DAR dhe Drejtorinë Ekonomike të Arsimit dhe do të përcjellim këtë problematike tek drejtori përkatës.

Manjola Tuzi – Falenderojmë për organizimin e këtij takimi por vitin e kaluar kemi dërguar dru nga shtëpia për të realizuar furnizimin dhe mbulimin me nevoja të shkollës “Ndre Mjeda”. Duhet riparë furnizimi me dru. Nuk është normale që shkollat të rrijnë pa furnizim me dru, ndërkohë që ndërmarrja pyjore ka të magazinuar dru dhe nuk furnizohen shkollat. Tjera problematika:

1. Shkolla “28 Nëntori” nuk ka asnjë ndriçim rreth e rrotull gjatë natës dhe aty ka një problem sigurie edhe për njerezit që kalojnë apo të rinjtë që mund të abuzojnë, mjaftojnë edhe pak ndricues.
2. Gjatë rrugës nga zona industriale ka mungesë të KUZ duhet të verifikohen sepse me një rreshje shiu i gjithë uji nga bllokimi i kanaleve shkaktajnë përmytje për lagjet tona. (Lagjja Tepe)
3. Duhet të ketë vëmendje të shtuar në pastrimin e kanaleve dhe pusetave në të gjithë zonën. Ka mbi 100 puseta të cilat janë të pambyllura dhe të bllokuara.
4. Shkollat dhe oborret e tyre duhet të kenë kujdes edhe për sa i përket mbjelljes së pemëve dhe gjelbërimit për të krijuar edhe një ambjent rekreativ dhe shtim të elementëve dekorativ dhe hapësirave të gjelbërta.

Zv. kryetari – Do të diskutojmë me drejtorinë e shkollës “28 Nëntori” sa i përket ndriçimit.

Sa i përket druve dhe mungesës së tyre në shkolla do të verifikojmë me drejtorinë ekonomike të arsimit. Drutë e magazinuar në drejtorinë e pyjeve janë në sekuestro dhe pa u shprehur prokuroria nuk mund të përdoren.

Për verifikimin e pusetave dhe kanaleve KUZ është ngritur që tre jave një grup pune i cili do të verifikojë të gjithë situatën .

Adriano Parubi, banor rajoni nr. 3 - Sa i përket problematikave kemi nevojë për transportin sidomos për nxënësit, sidomos gjatë sezonit të dimrit është edhe më e nevojshme. Transporti urban nuk është i saktë në oraret që duhet të ndjek dhe duhet verifikuar nga drejtoria e shërbimeve apo drejtoria arsimore që të vendoset në dispozicion një mjet sidomos për nxënësit.

Nga fermentimi deri në shkollën “Pashko Vasa” e me rradhë janë 30 minuta në këmbë dhe gjatë dimrit kjo është shumë problematike.

Zv. kryetari – Do të verifikohet me shërbimin publik për respektimin e këtyre orareve.

Dhurata Tyli – kam një problematike që e kemi diskutuar edhe gjatë tre viteve për sa i përket futjes në buxhet të një punonjëseje ndihmëse në Shkollën Speciale. A ka një përgjigje konkrete se kur do të filloj punë punonjësja mbështëtese në shkollën “3 Dhjetori”?

Zv. Kryetari – jemi në përfundim të kontratës dhe brenda fundit të muajit do të jetë e mundur punësimi i saj.

2. Menaxhimi i mbetjeve

Dhurata Tyli – Mendoj që në të gjithë territorin e Shkodrës është bërë një punë e mirë por ka zona të cilat kanë shumë problem menaxhimin e mbetjeve. Konkretisht:

1. Pranë hyrjes së Shkodrës tek thertorja e Urës së Bunës ka pirqje me plehra dhe nuk pastrohen.
2. Pranë “Jumbo” kapakët e kazanave të plehrave janë me muaj të dëmtuar dhe mbetjet mbesin në trotuar.

Zv. kryetari – Kemi komunikuar edhe bashkë për këtë pjesë dhe herë pas here kemi ndërhyrë për të pastruar por duhet edhe ndërgjegjësim publik. Ne kemi gati nje plan për të bërë një tjetër aksion pastrimi. Por duhet edhe të gjithë ne të bëjmë mediatizim dhe sensibilizim të kësaj problematike për banorët.

Tek kazanat pranë Jambo e dimë si problematikë ka edhe në zona të tjera por këtë muaj përfundon procedura e blerjes së kazanave të rinj dhe do të shpërndahen në këto pika kritike.

Dhurata Tyli – Problem është që në këtë zonë nuk pastrohet më. Dhe vetem ka akumulim të mbetjeve.

Zv. kryetari – vetë terreni ku thoni ju është problematik dhe nuk mund të bëhet pastrim i përditshëm, kryesorja është që të gjithë në të informojmë dhe të sensibilizojmë njerëzit edhe mediatikisht që të mos pastrojmë vetëm me aksione por vetë banorët të mbajnë këtë zonë të pastërt.

Dhurata Tyli – të ketë vemendje edhe për punonjësit e zonës të cilët nuk pastrojnë dhe nuk e kryejnë detyrën e tyre.

Ervin Gjini – në rajonin nr. 3 kryesisht pastrimi bëhet mirë, ndoshta zona më problematike është zona e pedonales, këtu nga fluksi i madh dhe numri i lartë i lokaleve shpesh krijohen grumbull mbeturinash. Duke qënë se në këtë zonë po bëjnë edhe ndërtime, firmat që punojnë shpesh bejnë edhe ndotje të pedonales dhe gurëve të pedonales dhe duhet që me shpesh të realizohet pastrim me vemendje të shtuar. Duhet që të shtohet frekuenca e pastrimit në pedonale sidomos gjatë periudhave ku ka turistë dhe vizitorë.

Zv. kryetari – Në pedonale dhe rrugën “Kolë Idromeno” po përfundon procedura e vendosjes së koshave të vegjël më të shpëstë dhe më të menaxhueshëm.

Sa i përket larjes dhe dizinfektimit te zones është e drejte dhe do te marrim masa për shtim te vemendjes.

Fred Zefi – pikërisht tek Truma e Dugajve të reja janë 7 kosha në një vend dhe nuk e di a është e mundur pavarishtë nevojës së madhe që ka zona që këto kosha të shpërndahen në dy apo më shumë pika grumbullimi, sepse krijohet edhe trafik edhe ndotje duke qënë se ka shumë volum ndotjesh e mbeturinash në një vend.

Erjon Metushi, Anëtar i Këshillit Bashkiak – Falenderoj pjesëmarrësit në salle dhe nën kryetarin për përgjigjet dhe mbajtjen e shënimeve për problematikat që besojmë do të gjejnë zgjidhje. U përmend më sipër shqetësimi me pjesën e mbeturinave nga spitali – fermentimi, si dhe rrjetit të pushtave. Sa i përket mbeturinave në këtë zonë problemi është tek mbeturinat e shkarkuara nga ana e fasonerive. Për këtë duhet të gjindet një zgjidhje e qëndrueshme sepse të gjithëve na vijnë foto dhe raportime nga ndotja që shkaktojnë në pikat e grumbullimit të planifikuara për banorët e bizneset. Ndoshta ka zgjidhje do ishte rritja e gjobës ndaj këtyre fasonerive.

Zv. kryetari – sa i përket mbingarkesës së kazaneve pranë trumës kjo është goxha e vështirë megjithatë kemi diskutuar edhe me administratorin e rajonit 3 për këtë. Kemi shpesh vështirësi për ti vendosur pikat e grumbullimit sepse askush nuk i do pranë ambjentëve të tija.

Sa i përket problematikes së fasoneve ftoj **z. Alfred Luleta** si drejtues i shërbimeve publike të na sqarojë me teknikisht: Sa i përket mbetjeve fasone është një problematike e ndjekur në vite, mbetjet fasone janë të papranueshme në pikat e grumbullimi të bashkisë e gjithashtu në landfill nuk pranohen. Në bazë të ligjit fasonët duhet të kenë një kontratë me subjekte private sa i përket grumbullimit të mbetjeve të tyre por me sa duket këto kontrata nuk janë funksionale. Kemi zhvilluar një mbledhje sot me të gjithë kryetarët e rajoneve për të filluar dhe marrë kontakte me kompanitë fasone dhe gjetur zgjidhjen e qëndrueshme për këtë situatë.

Kemi marrë edhe kampionet nga pikat e grumbullimit dhe po procedohet me policinë bashkiake për marrjen e masave të gjobave karshi tyre.

Është një situatë e akumuluar tashme që një javë dhe shpresojmë të shkojmë drejt një zgjidhjeje. Gjyba është prej 20 mije lekesh të reja dhe këto masa janë të nevojshme por nuk janë zgjidhje e situates. Kryesore mbetet gjetja e bashkpunimit me prodhuesit fasone.

Andi Halluni – mbetjet që nuk kanë të drejtë të hidhen në landfill ku shkojnë dhe a mund të krijojnë bashkia një pikë tjetër grumbullimi?

Alfred Luleta – mbetjet mund të hidhen në landfill por duhet të dergohen aty me një tarifë tjetër më të lartë që rregullohet sipas kontratave private të tyre.

Andi Halluni - u diskutua edhe në takimet e lagjeve të tjera është problem edhe depozitimi i kutive dhe mbetjeve nga supermarketet.

Alfred Luleta – sa i përket hapjes së pikës së re në landfill është përgjegjësi e Ministris së Mjedisit. Për sa i përket supermarketëve do të zhvillojmë këto ditë një takim me to dhe të gjejmë një zgjidhje për ndarjet në burim të mbetjeve të tyre për të mos akumuluar këto mbetje në koshat e përcaktuara për banorë dhe biznese të vogla e të mesme.

Jemi në pritje të investimit të ri prej shtesës së 100 kazanave dhe duke bërë edhe ndarjen në burim të mbetjeve nga ana e supermarketëve mendojmë që situata do të jetë më e mirë.

Andi Halluni – kemi iniciuar që vitin e kalur një projekt propozim pilot për heqjen e kazanave në disa zona apo lagje, për të bërë grumbullimin derë më derë të mbetjeve sepse heqja e kazanave normalisht krijon edhe një pamje më të bukur dhe shërbim për banorët.

Zv. kryetari – është diskutuar si projekt pilot për një rrugë pra pastrimi derë më derë, si projekt propozim vijon të jetë në fuqi dhe do të përqipemi që të fillojmë ta zbatojmë në një rrugë për të parë ecurinë. E mirëkuptojmë këtë që thoni dhe jemi në dijeni që heqja e kazanave do të ishte edhe më mirë për ne si administratë.

Z. Shabani – duhet të rritet bashkëpunimi me shoqatat mjedisore të cilët mund të kenë rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin e popullsisë sa i përket mbetjeve dhe menaxhimit të tyre. Të gjithë shkojmë në Mal të Zi apo zona të tjera dhe vihet re që banorët vetë janë më të ndërgjegjësuar.

Sa i përket pastrimit (fshirjes së rrugëve) duhet të gjendet një orar i përshtatshëm për kryerjen e kësaj pune dhe të jetë një orar specifik ku përfundohet ndotja. Sepse nëse pastrohet në mesdite, pasditja dhe darka do të jetë sërish e ndotur.

Edhe një herë për sa i përket pushtave nuk ka problem tek fondet sesa tek vëmendja që duhet të ketë administrata për shtim të vëmendjes dhe punës në terren.

Zv. kryetari – pastrimi kryhet me frekuenca të caktuara sipas kontratës sepse mund të ketë nevojë për shtim frekuencash, ndërsa sa i përket fshirjes ajo realizohet gjatë natës dhe përveç pedonale që ka frekuencë tjetër.

Jona Leqejza, Këshilltare Këshilli Bashkiak – fasonet e shmangin depozimin në landfill sepse kanë tarifë më të lartë private, ndërkohe landfilli nuk i pranon nga bashkia sepse ka të kontraktuar një vlerë të caktuar me bashkinë për depozitim.

1. A është menduar që të bëhet një diferencim i kostos për landfill për sa i përket fasoneve sepse mbetjet e prodhura nga fasonerit janë gjithsesi të riciklueshme?
2. A është menduar që të bëhet një projekt i veçantë apo nisëm për një pikë grumbullimi nga bashkia për këto mbetje të cilat janë të riciklueshme dhe janë lënde e parë për shumë biznese të tjera të cilat i blejnë këto mbetje.

Ndoshta fasonet si grup interesi duhet të thirren dhe të bëjnë një diskutim të hapur për këtë temë.

Erjon Metushi, Këshilltar bashkiak – tarifa është mujore apo për cdo rast që kanë nevojë të depozitojnë. Sa i përket gjobave a mund të bëhen publike edhe për ndërgjegjësim të firmave fasone por edhe për të ndarë problematiken edhe me qytetarët?

Alfred Luleta - Tarifa nuk vendoset nga bashkia por nga landfilli, tarifa është me tonazh për sa i përket fasoneve dhe sipas nevojave ato bëjnë depozitim dhe paguajnë në bazë të tonazhit sipas kontratave që kanë me operatorin privat.

E kemi menduar edhe këtë që thoni për publikim të gjobave por gjithsesi me takimin që kemi bërë edhe sot me administratorët mendojmë që do të kemi edhe ndërgjegjësim nga ana e këtyre subjekteve.

Erjon Metushi – sygjërim im është që të dërgohet një shkresë apo paralajmërim për sa i përket të drejtave dhe përgjegjësisë që kanë dhe të vendosen edhe gjobat përkatëse, për të dhënë përgjegjësinë ndaj këtyre bizneseve.

Zv. kryetari – fasoneritë dhe këto biznese janë biznese të mëdha në Shkodër dhe shpesh edhe bashkëpunëtor. Ne jemi duke u munduar që të gjejmë rrugën e bashkëpunimit me to për të gjetur zgjidhje të mirëkuptimë. Në rastin që nuk do të gjejmë zgjidhje për këtë situatë do të vijojmë me gjobitje dhe mediatizim të kësaj situatë për të mos mbajtur bashkia këtë barrë.

Andi Halluni – Kur të behët kontrata e re me kompaninë e pastrimit të vendoset në dispozicion edhe lagjja e rrugëve dhe jo të angazhohet ujësjellësi.

Tonet Shoshi, Inspektor rajoni nr. 3 – një tjetër sugjerim është që duhet të shtohet jo vetëm lagjja e rrugës por edhe mjete të vogla të nevojshme për rrugët e ngushta të qytetit ku me makineritë e mëdha është e pamundur që të futen në këto rrugica dhe lagje. Nevoja është e madhe për shtim edhe të kazaneve pranë Merkatës së rusit. Po ashtu edhe pranë rrugës “Marin Bicikemi”, rruga “Jeronim De Rada” pranë bibliotekës së universitetit ka nevojë për shtim kazanesh. Gjithashtu edhe punët e riparimit që kryen operatori ekonomik me kazanat ti bëjnë në një magazinë apo pikë të caktuar dhe jo në rrugë. Së paku në qendër të qytetit, në pedonale të bëhet një projekt pilot sa i përket diferencimit të mbetjeve, duke parë edhe numrin e lartë të turistëve dhe vizitorëve.

Për propozimin e subvencionimit të bizneseve jam dakort dhe është arterie e zhvillimit të qytetit, por duhet të shikohet edhe taksa ndaj banorëve dhe të mbahet në vëmendje kontrolli ndaj kësaj kostoje për banorët që shpesh janë në vështirësi financiare.

Zv. kryetari – me kontratën e re që do të bëhet janë kërkuar edhe makineritë e vogla sepse është një problematikë me të cilën jemi përballur në vite.

Për një muaj do të kemi shtesë të numrit të kazanëve për ti shpërndarë sidomos në qendër të qytetit. Gjithashtu do të bëhen me një veshje për të reduktuar edhe impaktin viziv.

Për rrugën “Kolë Idromeno” dhe Gjuhadol, projekti pilot që do të zhvillohet medeomos do të fillojë në këtë rrugë duke shpresuar edhe në ndërgjegjësimin e banorëve dhe vizitorëve.

Erjon Metushi – për pjesën e dezinfektimit, sidomos në verë, të kazaneve duhet të shtohet medeomos frekuenca. Kurse për sa i përket diferencimit, ne mund të bëjmë diferencimin e mbetjeve në një zonë por pastaj do të jetë i njëjti mjet që do t’i grumbullojë.

Zv. kryetari – sa i përket çmimeve dhe tarifës së pastrimit, me rritjet e çmimit të naftës është bërë shumë e vështirë menaxhimi i këtyre kostove, ndërkohë që ne kemi kërkesa në rritje për shërbimin.

Adi Parubi - Një tjetër problem ka të bëjë me mbetjet nga fasoneritë sidomos gjatë natës duke i depozituar në zonën e Zallit të Kirit, duke i djegur pastaj dhe krijuar problem edhe për banorët. Duhet që të verifikohet kjo situatë dhe të gjobiten apo raportohen në Policinë e shtetit.

3. Ndriçim gjelberimi

Dhurata Tyli - Ne e kemi diskutuar edhe në mbledhje të këshillit sa i përket pemëve dekorative të cilat janë rritur aq shumë tashmë sa krijojnë problem deri në katet e 4 dhe të 5 të pallateve. Duhet që të ketë ndërhyrje në të gjithë qytetin. Edhe ndarjet e rrugëve me gjelbërim duhet të verifikohen dhe të reduktohen sepse shpesh këto trafik ndarëse bëhen burim aksidentesh.

Zv. kryetari – Është ngritur një grup pune sa i përket ndërhyrjeve në gjelbërimin e qytetit.

Ervin Gjini – edhe një herë kthehem në zonën e pedonale, është pjese që duhet të ketë ndriçim dhe aty shumë ndricues janë të dëmtuar gjithashtu pjesa e Skenderbegut ka problem (nga nënstacioni – kryqezim spitali) ka ndriçues të vendosur por nuk funksionojne. Zona pedonale është shumë problematike, pjesa më e madhe janë dëmtuar nga vetë qytetaret, megjithatë bashkia duhet te nderhyje dhe te sistemoje keto pika.

Erjon Metushi – një sugjerim që vlen për zonën është edhe vendosja në një formë tjetër e këtyre ndriçuesve duke u varur nga skaji në skaj duke liru edhe vendin e hapsirën dhe rritur qëndrueshmërin e tyre.

Zv. Kryetari– ka një projekt për këto rrugë dhe është nje projekt konkret zbatimi ku do te vendoset ndriçim i ri pa shtylla dhe do te kemi nje zgjidhje te kesaj problematike duke dhene edhe impakt ne zone.

Për pjesen e ndriçimit prane spitaleve ka ndriçim por do te verifikohet situata.

Ndersa ne pjesen e Unazes nuk është marre ne dorezim nga bashkia Shkoder dhe nuk mund te nderhyjme.

Tonet Shoshi – tek katedralja në Gjuhadol ka dy shtylla që janë të dëmtuara dhe duhet të ndërhyhet nga ana e bashkise duke qene se është edhe zone turistike dhe me shume vizitore , ka shumë kohe që nuk gjen zgjidhje ndërkohë qe mendoj se është e realizueshme.

Për projektin e ndriçimit me ndricues të varur shpresojme edhe ne mirëkuptimin e banorëve të shtëpive dhe bizneset qe do të kenë këto ndricuesa ne fasadat e tyre.

Alfred Luleta – Për problematikat qe thoni në sheshin e katedrales Gjon Pali këto dy ndricues do te ndryshohen brenda 2 – 3 javesh. Është përfunduar prokurimi dhe do te nderhyjme.

Andi Halluni - Keshilltar i Këshillit bashkiak - Falenderim për drejtorinë dhe sektorin e ndriçimit sepse ka shume problematika por të gjithë ne kemi bashkëpunim shumë të mirë me këtë drejtori ku sa herë që identifikojme problematike arrijmë t’i zgjidhim.

Sa i përket ngërrcit me ARRSH për rruget e padorezuara me dokumentacion tek Bashkia Shkodër a do të zgjidhen ndonjë herë këto situata sepse është unaza – bypassi dhe rrugë të tjera qe janë në të njëjtën problematike .

Zv. kryetari – kemi zhvilluar edhe takime me këto drejtori dhe shpresojmë të marrim përgjigje të sakta por nga ana e bashkisë ne i kemi bërë të gjitha procedurat tona.

Fred Zefi – duhet të kemi zëvendësim të pemëve që janë tharë apo zhgultur, nuk e di a ka një projekt të saktë për gjelbërimin e qytetit sipas një plani të mirëfilltë.

Zv. kryetari – është bërë një plan për shtimin e disa zonave me pemë. Kemi filluar një ndërhyrje për pjesën e Xhabijes por duke qenë se presim edhe fillimin e punës për ndricuesit dhe janë të lidhura si aktivitete jemi akoma në pritje. Sa i përket problematikës së ujitjes me bote është shumë e drejtë, kemi vendosur impiante në disa lulishte por është e saktë ndërhyrja e juaj për shtese të këtyre impianteve.

Adi Parubi – Zona industriale dhe fermentimi ka shume llampa që janë të djegura dhe duhet të verifikohen. Kurse sa i përket gjelbërimit ka nevojë për shtim të krasitjes sepse ka vite që nuk ka krasitje dhe mbulojnë tashmë edhe sinjalistikën.

Zv. kryetari –Për ndriçimin jemi në proces të identifikimit dhe zëvendesimit të tyre. Kurse për gjelbërimin do ta raportojmë tek operatori ekonomik dhe do ndërhyhet.

Anton Deda, Këshilltar këshilli bashkiak - Shumë pranë pedonales është lulishtja e dollarit siç quhet. Aty ka një problem me ndriçimin e kësaj zone sepse ka edhe grumbullim të të rinjve dhe përdoruesve të drogës duke u bërë një zonë e pasigurtë. Investimi me ndriçim të shtuar në këtë zone duke qenë edhe shumë pranë pedonales duhet të kete një vemendje më të madhe dhe të krijohet si pikë atraktive për të rinjtë dhe banorët, ku mund të zhvillohen edhe aktivitete rekreative.

Andi Halluni – Për sa i përket lulishteve rajoni nr. 3 ka shumë lulishte dhe problem për këto lulishte edhe edhe mungesa e banjove publike. Jane ambjente të frekuentuara nga të gjitha moshat dhe është e nevojshme të merret ne konsideratë vendosja e banjove publike.

Tonet Shoshi – a ka nje plan bashkia për të identifikuar dhe liruar lulishtet në Shkodër të cilat janë të zëna me ndërtime pa leje ose shpesh të rrethuara dhe në përdorim nga biznese apo banorë pa të drejte.

Zv. kryetari – Është shumë i nevojshëm ndërhyrja dhe investimi për banjo publike dhe me patjeter do të kemi një fond në buxhetin e ri për këtë pjesë.

Sa i përket lirim të hapësirave publike do të zhvillojmë një plan konkret ndërhyrjesh dhe shpejt do të bejmë një ndërhyrje për lirin e hapsirave të zëna nga ndërtimet pa leje nga baret dhe lokalet. Jemi edhe duke identifikuar lulishte ku do të ketë investime për mjedise rekreacionale dhe sportive.

Tonet Shoshi – tek lulishtja pranë universitetit është zënë e gjitha nga ndertimi i objekteve pa leje duke shkaterruar komplet lagjen. Gjithashtu banjot publike i mbajmë mend dhe sot janë të rrethuara nga hekurat dhe nuk lejohet përdorimi i tyre.

Zv. kryetari – problemi është i trashëguar dhe shpesh kemi objekte të legalizuara edhe në trotuar duke vështirësuar edhe më shumë ndërhyrjen tonë. Megjithatë për ne është prioritet ndërhyrja në lirin e hapësirave publike.

Dhurata Tyli – të gjitha katet e para të pallateve kanë zënë hapësirat publike pranë banesës së tyre. Dhe kjo duhet verifikuar dhe liruar sepse nuk janë private. Po ashtu është i domosdoshem shtimi i bumeve dhe sinjalistikes.

Zv. kryetari – Në fakt, ku kemi ndërhyrë në lirim të hapësirave publike jemi përballur me problematiken e pronësise apo objekteve ne legalizim.

Anton Deda - keshilltar keshilli bashkiak - Për infrastrukturen rrugore sic tha z. Fred Zefi është e nevojshme kalimi me nje sens i rruges se trumes. Nga ish- 5 Herojte drejt ish Deges se brendshme ka shume fluks trafiku sidomos gjate veres, kjo edhe nga kalimtarete dhe vijat e bardha. Duhet të mendohet mundësia e vendosjes së semaforit në këtë pikë që mund të rregullonte trafikun.

Zv. kryetari – jemi drejt përfundimit të bërjes me një sens të rrugës pranë trumës në dalje të pedonales.

Fred Zefi – duhet të shihet në një plan me të gjerë përmes analizimit të të gjithë zonës dhe jo vetëm rrugës.

Zv. kryetari – me patjeter qe plani behet për te gjithë trafikun ne zone jo vetem për nje rruge.

Ervin Gjini - Ne kuader te investimeve :

1. Ne Zonen e pedonales duhet te rishikohen demtimet e medha qe jane bere ne zone nga mjetet e tonazhit te larte qe kane demtuar pedonalen dhe guret e zones.
2. Sa i perket zenies se rruges nga mjetet me dhe pa te drejte shohim qe ka kona dhe penguesa prane bizneseve pa te drejte per vendosjen e makinave te tyre nderkohe parkimet jane publike.
3. Vite perpara ka pasur nje projekt per realizimin e parkingut nentokesor ne qender te qytetit duke parashikuar edhe mbikalimin dhe nenkalimin qe do te lehtesonte edhe trafikun per qendren e qytetit. Ky investim do te ishte ne favor te banoreve por edhe te bashkise Shkoder.

Zv. kryetari – kemi bere disa nderhyrje ne pedonale per permiresimin e infrastruktures ne zonen e pedonales, megjithate edhe firmat e ndertimit qe marrin lejet per ndertim duhet ta rikthejne ne gjendje fillestare.

Ervin Gjini – Gjithashtu duhet rritur presioni nga ana e bashkise per dy apo tre ndertesa qe jane lene ne harrese dhe nuk investohen nga banoret dhe nderkohe jane gangrene edhe per zonen e cila eshte monument Kulture.

Nje tjetër kerkese eshte sa i perket orareve te lokaleve dhe trafikut ne zonen e pedonales sepse per banoret eshte shume problem jetesa ne kete zone.

Zv. kryetari – kemi bere nje shtyerje te orarit te shfrytezimit te ambjenteve biznese ne zonen e pedonales, duke para edhe numrin e larte te turisteve dhe vizitoreve si dhe duke marre parasysh dhe mos rrespektimin e trafikut te makinave kemi vendosur qe se paku te lihen ne perdorim nga bizneset duke qene se eshte bere nje rruge turistike me frekuentim te larte nga te gjithe vizitoret sipas tabelës se ndalimit te qarkullimit.

Ervin Gjini – a mund te behet rritje e numrit te policve bashkiake per te shtuar vemendjen dhe monitorimin nga ana e nje strukture sidomos per keto pika ku ka fluks te larte vizitosh?

Zv. kryetari – medeomos vitin tjetër do te kemi nje vemendje tjetër e me te shtuar per kete zone dhe jo vetem, Shkodra dhe territori yne eshte shume i madh dhe me numrin e kufizuar te policve qe kemi eshte e pamundur qe te kemi presence polici fizik dhe prandaj sepaku eshte kerkuar mbyllja e rruges me tabele.

Jona Leqejza - Per me tepër ka nje shkelje te vazhdueshme flagrante te rregullave te qarkullimit. Nderkohe qe ka edhe tavolina nga lokalet qe ushtrojne aktivitetin e tyre shpesh duke zgjeruar edhe hapësiren e dhene. Eshte absurde qe pedonalja te shfrytezohe per parkim ,por se paku te vjelim te ardhura duke pasur mundesi te mirembajme ose te investojme dicka tjetër. Nese jeni dakort drejtohem edhe publikisht edhe me shkrese per sa i perket tarifimit.

Andi Halluni – per si perket pedonales dua edhe te falenderoj keshillin per vendimin qe ka marre per lirimin e pedonales dhe dua te falenderoj edhe bashkine dhe administraten per nderhyrjet dhe vemendjen qe ka pasur ne lirimin e saj duke e kthyer ne nje atraksion te mirefillte.

Tonet Shoshi - zona e pedonale ka pasur mbipopullim dhe medeomos do nje vemendje te shtuar dhe shum me kujdes. Kete vit është lejuar përdorimi i ketyre hapsirave por duhet qe te kemi edhe vjelje te taksave për shfrytezim te hapësires publike.

Megjithate ka nevojë për nderhyrje ne rruget:

1. Rruga Paloke Nika prane fushes se lekurave – 500 metra rruge
2. Prane market SPAR, shesh pallati rikualifikim
3. Zona e fermentimit ka nje numer te larte rruges me nevoja KUZ dhe KUB.

Ne jemi drejtuar edhe me shkresa dhe do verifikohen sipas prioritetit.

Për qarkullimin tek pjesa e qendres se Shkodres, projektet e medha ndoshta jane te veshtira por 4 semafore dhe nje sherbim policimi fizik do te ndikonte shume. Gjithashtu rritja e bashkepunimit me policine e shtetit do te lehtesonte dhe edukonte edhe qytetaret dhe përdoruesit e automjeteve.

Zv. kryetari – Faleminderit për propozimet e rrugeve për tu vleresuar dhe futur ne buxhet.

Adi Parubi -

1. Tek zona industriale ka nevojë se paku për skavator qe te behet sheshimiI zones sepse e dime qe jane shume te gjata si rruge dhe veshtira te investohen.
2. Prane fushes se lekurave është nje rruge shume e shkurter, maksimumi 100 metra dhe duhet vleresuar realizim i saj .
3. Rruga Gjovalin Gjadri, bumet jane sheshuar dhe amortizuar dhe kjo krijon problem sepse është nje zone ku levizet me shpejtesi te madhe duke u bere burim aksidenti.

Zv. kryetari – jemi ne fazen e tenderimit te sinjalistikes se rrugeve dhe bumeve dhe do te kemi mundesi për te nderhyre shpejt.

Tonet Shoshi – prane rruges Gjosho Vasija jane dy rrugica te vogla prej 40 dhe 60 meter linear dhe është e nevojshme te behet nderhyrje ne rretin rrugor dhe ate KUZ dhe KUB. Jane nderhyrje te vogla por me shume impakt edhe ne numrin e banoreve edhe sa i përket vjetersise se lagjes.

4. -Sherbimi shendetsor

Zv. kryetari - Jane te njejtat diskutime ne te gjitha degjesat por ne kemi zhvilluar takimin me drejtuesit e qendres nr. 2 dhe lagjen nr. 3 dhe kemi diskutuar si për problematikat e infrastruktures, lagshtine dhe hyrjen e përbashket si për pacientet ashtu edhe për te tjere.

Mendoj qe deri javen tjeter do te zhvillojme takimin konkret me drejtuesit e qendrave shendetsore për te marre specifikesht nevojat për keto qendra.

Adi Parubi – Zakonisht qendrat shendetsore mbyllin ne oren 12 dhe ndërkohe orarin e kane deri ne 3.

Erjon Metushi – do ta adresojme kete problematike edhe me drejtuesit e qendrave.

Nen kryetari: mbyll takimin duke falenderuar edhe banoret edhe keshilltarët dhe përfaqesuesit e Projektit Star 3.

Gerti Shella – Faleminderit për pritjen edhe sot, problemet qe diskutohen këtu jane probleme qe i kane qytetet e medha si Tirana Durrësi etj.

Doja ne fakt konkretisht te pyesja : a ka bashkia nje strategji dhe plan te mirefillte për menaxhimin e mbetjeve. Kjo do te identifikonte edhe konkretisht nevojat dhe formen konkrete për menaxhimin e mbetjeve.

Ndoshta edhe përmes partnereve sic jane austriaket apo UNDP për sa i përket marrjes se praktikës sa me te mire për kete funksion.

Zv. kryetari i bashkise – për sa i përket strategjisë së menaxhimit të mbetjeve jemi duke draftuar këtë strategji.

Gerti shella do te jemi shume te kenaqur qe te përfshihemi dhe te jemi pjese e zbatimit dhe përcimit te kesaj strategjia si dhe zhvillimin e degjesave publike.

Dhurata Tyli – falenderoj nen/kryetarin për punen e deritanishme gjithashtu përfaqesuesit te projektit Star 3 për mbështetjen.


Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka. Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Mbajtësi i Procesverbalit:

Bekim Mema







BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.
Lagja nr.3

NR	EMËR	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
1	IGLIBI	SHOGRI	M		SHKODER	INSPEKTOR	IASAKI
2	SHKODER	SOKOLE	M	55	SHKODER	JURIST	A.K.U.
3	AMOLI	ABELLUMI	M	48	SHKODER	JURIST	PRIPROT
4	ALFRED	ZEFI	M	45	Rr. Jullij	dingtur/financ	prk
5	EVAN	GJINI	M	45	Rr. "Kokesh"	Ahmuni/strata	Barba
6	HASIMIA	GENÇANI	F	38	SHKODER	Ekonomist	B. Shkodër
7	ALFRED	LULETA	M	56	SHKODER	JURIST	B. Shkodër
8	BENIN	MUSHI	M	41	SHKODER	Inspektor	B. Shkodër
9	HARIZI	SHABAN	M	67	SHKODER	Penalji	Pa. Sh.
10	MAMJOLA	TUJI	F	45	SHKODER	Rrethbopje	vet. punësim
11	DURATA	TYLI	F	68	SHKODER	Pensioniste	Keshilltare
12	GJONI	PAPAJ	M	37	SHKODER	-	Pa. Pun.
13	NIK	PJOKLAJ	M	63	SHKODER	-	Pa. Pun.

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK

